



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 56250-01689-00-2018 i Rregj. Themeltar
Nr. 00 – 2024 – 77 i Vendimit**

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Ilir PANDA	- Kryesues
Medi BICI	- Anëtar
Albana BOKSI	- Anëtare

Më datë 25.01.2024, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale që i'u përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

KUNDËR: Violand Braçellari

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Medi Bici dhe e bisedoi çështjen në tërësi, përfundim;

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes:

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në funksion të procedimit penal nr. 1143, i vitit 2015, ka paraqitur për gjykim, para asaj gjykate, të pandehurin Violand Braçellari nën akuzën e “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

2. Gjykatat e faktit kanë pranuar këto rrethana të çështjes: Në datën 29.09.2015, rreth orës 21.00 është marrë njoftim nga Salla e Drejtimit Korçë, se në vendin e quajtur “Çezma e Senishtit”, ndodheshin dy mjete të dyshuara për drogë. Me marrjen e këtij njoftimi punonjësit e policisë kanë shkuar në vendin ngjarjes, ku kanë konstatuar të ndaluar një automjet “Ford Mondeo”, me targë AA 765 LE, me drejtues mjete shtetasin Haxhi Goseni. Pas rreth 15 minutash nga konstatimi i automjetit

të mësipërm, ka ardhur një automjet tjetër, “Mercedes Benz” me targa AA 217 ED, me drejtues mjete shtetasin Fest Suli dhe pasagjerë shtetasit Ylli Musaku dhe Violand Braçellari.

3. Nga kontrolli i ushtruar automjetit “Mercedes Benz”, me targa AA 217 ED, është konstatuar se në pjesën e pasme të bagazhit ndodheshin tre paketime me qese plastike të zeza për hedhje mbeturinash, të pahapura dhe të mbështjella me etiketën origjinale të tyre dhe një pako me doreza kirurgjikale me ngjyrë të bardhë. Ndodhur në këto kushte, këta shtetas janë shoqëruar pranë Drejtorisë Vendore të Qarkut Korçë dhe gjatë verifikimeve, nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore është bërë këqyrja e aparatit celular të markës “Black Berry” që i përkiste të pandehurit Violand Braçellari, ku kanë rezultuar pamje fotografike dhe video me lëndë të dyshuar si narkotike, të mbjella, duke u transportuar, tharë, etj.

4. Nga kontrolli i ushtruar në banesën, në posedim të të pandehurit Violand Braçellari, e ndodhur në fshatin Lozhan i sipërm, është konstatuar se, në katin e dytë, në një dhomë në anën perëndimore të saj, u gjetën disa mbetje bimësh të thata me aromë dhe ngjyrë të ngjashme me atë të bimës narkotike “cannabis sativa”, që pas peshimit të tyre kanë rezultuar 10.8 gram.

5. Sipas aktit të ekspertimit kimik nr. 4628, datë 24.05.2016, ka rezultuar se materiali bimor është përzierje pjesë bime me cannabis, produkt herbal i bimës cannabis sativa L.

6. Janë marrë dhe sekuestruar dy aparate telefonike celulare të shtetasit Violand Braçellari nga ku ka rezultuar se në aparatit telefonik celular të markës “Black Berry”, në rubrikën “Chats” gjenden komunikime gjatë periudhës 22.09.2015-29.09.2015 me dy subjekte “Sandri” dhe “Toni”, të pidentifikuar si persona konkret.

7. Nga këto komunikime rezulton se shtetasi Violand Braçellari ka komunikuar në lidhje me lëndën narkotike, për tharjen e saj, për transportimin, etj. Gjithashtu në telefonin celular të markës “Black Berry” janë administruar dhjetëra fotografi, në të cilat dokumentohet parcela ku është mbjellë lënda narkotike, vjelja e saj, tharja e saj në bombola gazi dhe transportimi i saj me kafshë samari.

8. Në këto kushte shtetasi Violand Braçellari është akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe me këtë akuzë është dërguar në gjykim.

9. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë**, me vendimin nr. 657, datë 19.12.2017 ka vendosur: Deklarimin fajtor të pandehurit Violand Braçellari, për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim. Vuajtja e dënimit do të fillojë nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi, duke u përlllogaritur edhe periudha e paraburgimit e vuajtur prej të pandehurit gjatë hetimeve paraprake. Dënimi do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

9.1 Gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera arsyeton: *...Nga analiza e mësipërme e provave rezulton e provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se nga i pandehuri Violand Braçellari, në bashkëpunim persona të tjerë ende të pidentifikuar janë konsumuar elementët e veprës penale “Prodhimit dhe shitje e lëndës narkotike”, parashikuar nga neni 283/2 i KP, duke cenuar në këtë mënyrë marrëdhëniet juridike të vendosura dhe garantuara nga shteti për të ndaluar, tregtimin, mbajtjen dhe transportimin e lëndëve narkotike, përdorimi të cilave sjell pasoja të rënda për shëndetin dhe shoqërinë në përgjithësi. Nga ana objektive, kjo vepër penale është konsumuar me veprime aktive të të pandehurit, në formën e mbajtjes, por edhe transportimit të lëndës narkotike së bashku me persona të tjerë të pidentifikuar të një sasive dukshëm të konsiderueshme lënde narkotike, nga e cila është bërë e mundur gjetja e vetëm 10.8 gram lënde narkotike “cannabis sativa” L. Për sa i përket elementit bashkëpunim, referuar qëndrimin të mësipërm të KB të GJL rezulton se provohen në mënyrë kumulative kushtet e elaboruara prej saj në lidhje me ekzistencën e bashkëpunimit për kryerjen e kësaj vepre penale, pasi: Së pari, vepra penale rezulton të jetë kryer*

nga disa persona, të pidentifikuar, ku dy prej tyre nga komunikimet telefonike permanente me të pandehurin Violand Braçellari quhen, apo janë shënuar në telefon si Toni dhe Sandri, ndërkohë nga pamjet fotografike të gjetuar në celularin e tij, rezulton se ai së bashku edhe me persona të tjerë, nëpërmjet kafshëve të samarit ka transportuar lëndë narkotike, dyshuar nga vendi ku është kultivuar, për në vendin ku kryhej tharja dhe magazinimi i saj. Pavarësisht mos identifikimit të bashkëpunëtoreve, KB të GJL mbajnë qëndrimin se: "...kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet kur nuk identifikohen bashkëpunëtorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paafësisë apo moshës për përgjegjësi penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë"; Së dyti, referuar elementëve të figurës së veprës penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", parashikuar nga neni 283 i K. Penal, siç u arsyetua më sipër, rezulton se ato janë konsumuar plotësisht prej tyre; Së treti, bashkëpunëtorët e pidentifikuar kanë dhënë një kontribut rilevant për realizimin e faktit penal nëpërmjet sigurimit të mjeteve për tharjen e lëndës narkotike, sigurimin e kafshëve të samarit dhe transportit të saj. Fakte këto që rezultojnë qartë nga pamjet fotografike, komunikimet telefonike midis të pandehurit dhe bashkëpunëtoreve, si dhe lëndës narkotike të gjetur në banesën e përdorur prej të pandehurit, ku edhe është tharë kjo lëndë. Për sa i'u përket roleve, nuk rezulton një ndarje e qartë rolesh, pasi ata shfaqen në role të ndryshme si bashkë organizatorë, ndihmës, apo ekzekutorë të veprës penale. Gjithsesi, ky fakt nuk përbën të metë të akuzës, pasi mjafton bashkëpunimi i tyre në kryerjen e veprës penale, edhe pa u përcaktuar qartë roli i secilit në kryerjen e saj; dhe së katërti, ekziston jo vetëm dijenia e tyre për veprën penale, por një marrëveshje dhe dashje e nxitur nga qëllime përfitimi për kryerjen e kësaj vepre. Komunikimet telefonike provojnë marrëveshjen dhe dijeninë e tyre për procesin e tharjes dhe transportit të lëndës narkotike.

9.2 Gjithashtu, pamjet fotografike që tregojnë transportin e lëndës narkotike me kafshë samari, provojnë qartë marrëveshjen dhe dashjen e tyre për kryerjen e kësaj vepre penale....Nga ana subjektive, rezulton se i pandehuri, e ka kryer veprën penale me dashje me qëllim përfitimi. Kjo pasi e ka ditur që mbajtja dhe transportimi i lëndës narkotike dënohet penalisht, e ka ditur që së bashku me bashkëpunëtorët e tij ishte, duke kryer një vepër penale dhe me marrëveshje dhe dëshirë, i nxitur nga qëllime përfitimi e ka kryer atë. Pra, kemi një përputhje të plotë midis elementit intelektual dhe atij volitiv. Nga sa më sipër rezulton se i pandehuri me veprimet e tij ka konsumuar të gjitha elementët e figurës së veprës penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve" kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i KP....Në lidhje me pretendimet e të pandehurit dhe avokatit të tij për paligjshmërinë e kontrollit, sendeve të përftuara prej tij, mungesën e lidhjes së lëndës narkotike të gjetur me të pandehurin, faktin se telefoni i sekuestruar ishte blerë prej të pandehurit disa ditë më përpara në treg dhe komunikimet, apo fotot nuk i përkisnin atij, gjykata i gjen të pabazuara pasi provat e mësipërme të analizuara qoftë më vete, apo në tërësi bindin gjykatën për kryerjen prej tij të veprës penale. Gjykata thekson se, komunikimet e të pandehurit me bashkëpunëtorët e tij, ende të pidentifikuar; pamjet fotografike të gjetura tek telefoni i tij, që tregojnë mbjelljen, transportin dhe tharjen e lëndës narkotike konfirmuar si cannabis sativa, gjetur në sasi të vogël në banesën e poseduar dhe përdorur prej tij për tharjen e lëndës narkotike, tregojnë qartë se i pandehuri është marrë me veprimtari të kundërligjshme sikundër pretendon akuzat. Edhe sikur secila prej këtyre të dhënave të mos përbënte provë, por të konsiderohej indicje, gjykata konstaton se, këto të dhëna (indicje) janë të rëndësishme, të sakta dhe të lidhura me njëra-tjetrën dhe provat e tjera të marra gjatë këtij gjykimi. Gjykata bazuar në nenin 152/2 të K.Pr.Penale, i cili sanksionon se: "Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveç se kur ato janë të

rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.”, duke shkuar në arsyetim të kundërt, pra duke i konsideruar indicje këto prova, arrin në përfundimin se, ato çojnë në përfundimin se, ekziston përtej çdo dyshimi të arsyeshëm fakti penal: transportimi i lëndës narkotike prej të pandehurit në bashkëpunim me persona të tjerë ende të pa identifikuar. Përsa i përket kontrollit, Gjykata vlerëson se ai është konform neneve 202-207 të KPP. Në rastin konkret, nuk jemi përpara kontrollit të realizuar me vendim gjyqate, por me iniciativë prej policisë gjyqësore, sipas paragrafit 3 të nenit të mësipërm. Që të konsiderohet i ligjshëm ky kontroll duhet që të plotësohen disa kushte, si: Së pari, të ekzistojë flagranca, ose ndjekja e personit që është duke ikur; dhe Së dyti, këto situata të mos lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli prej Gjykatës, pra të jenë emergjente dhe nga vonesa mund të dëmtohen hetimet. Nga provat e paraqitura rezulton se në rastin konkret kanë qenë në kushtet e emergjencës.....Nga faktet dhe arsyetimi i mësipërm, Gjykata krijon bindjen se plotësoheshin kushtet e paragrafit 3 të nenit 202 të KPP për kryerjen e kontrollit me iniciativë. Kjo pasi atyre i'u gjetën sende si qeset plastike të zeza, dorezat kirurgjikale dhe pamjet fotografike në celular, të cilat në kuptim të nenit 202/3, plotësojnë kushtet për t'u konsideruar gjendje flagrance, si dhe nga dinamika, apo dyshimet e krijuara, me një logjikë normale, pritja e vendimit të gjykatës, mund të favorizonte fshehjen e lëndës narkotike prej bashkëpunëtorëve, apo edhe të afërmve të tij, që do binin në dijeni të shoqërimit në polici. Përsa i përket procedurës së kontrollit, që përcaktohet nga nenet 203, 205-207, Gjykata konstaton se prej oficerëve të policisë gjyqësore janë respektuar këto rregulla, pavarësisht materializimit të kontrollit të disa banesave në të njëjtin procesverbal, konkretisht të banesës së Mitat Braçes, ku banon familja e të pandehurit dhe të banesës së Shefqet Braçellarit ku është gjetur lënda narkotike....

9.3 Përveç analizës së mësipërme, Gjykata duke analizuar në tërësi veprimet e policisë gjyqësore vlerëson se ato janë kryer në mirëbesim (takimi i të pandehurit me dëshmitarët Haxhi Goseni, Fest Suli dhe Ylli Musaku, në rrethana shumë të dyshimta, të cilat referuar vëndit, arsyeve që pretendonin këta shtetas pse ndodheshin aty dhe sendeve që kishin në automjet, krijojnë shumë dyshime dhe përforconin informacionin që kishte marrë policia për mundësinë e shkëmbimit të lëndës narkotike. Këto dyshime i kanë shtyrë punonjësit e policisë të kryenin veprime të mëtejshme hetimore, sikurse ishte kontrolli i banesës së të pandehurit dhe të banesave përreth), prandaj nën ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se mund të ndodhej lëndë narkotike në banesën e të pandehurit Violand Braçellari kanë vepruar menjëherë, në kushtet, kur vonesa mund të favorizonte fshehjen e lëndës narkotike të dyshuar....Pretendimi i ngritur se lënda narkotike e gjetur mund të jetë hedhur prej oficerëve të policisë gjyqësore, është tërësisht i pabazuar dhe në mungesë të një mbrojtje të bazuar në prova, pasi realisht nuk ka mundësi mbrojtjeje përpara provave të shqyrtuara dhe harmonisë që ato kanë. Lënda narkotike e gjetur në banesën, që nga dëshmia e Faneta Braçellarit (pronarja e shtëpisë) rezulton se është përdorur prej të pandehurit (familjes së tij), e cila furnizohej me energji elektike nga banesa ku banon familja e të pandehurit; ku ndodhej një kalorifer, pa patur asnjë shpjegim të logjikshëm për vendosjen e tij atje; me një konsum 3-fish më të lartë të energjisë elektrike në muajin Shtator 2015; që përkon me bisedat e tij telefonike me personat e tjerë për procesin e kultivimit, tharjes dhe transportit të lëndës narkotike, e fiksuar në pamje fotografike të ruajtura në telefonin e tij; telefon për të cilin pretendohet se ishte blerë, s'dihet se tek kush, disa ditë përpara arrestimit, por që çuditërisht vazhdonte komunikonte edhe disa orë para shoqërimit, për të njëjtat gjëra, me të njëjtët persona që kishte javë që komunikonte; që ndalohet nga policia “rastësisht” me disa persona të tjerë, që kishin në makinë tre pako qese të zeza dhe doreza kirurgjikale, disa orë pasi kishte biseduar me njërin nga bashkëpunëtorët aktivë për të sjellë tre pako qese të zeza, se ato që kishin ishin kapur me dore nga bashkëpunëtori tjetër; i përket padyshim të pandehurit Violand Braçellari dhe përjashtohet kategorikisht manipulimi i ngjarjes dhe provave

prej oficerëve të policisë, të cilët nuk kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme, por në mirëbesim, korrektësisht dhe brenda kapacitetit të tyre profesional, për të vënë përpara përgjegjësisë të pandehurin....

9.4 Përfundimisht, gjykata, duke qenë se prej të pandehurit Violand Braçellari janë konsumuar të gjitha elementët e figurës së veprës penale, e gjen dhe deklaron fajtor për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i KP...Për caktimin e llojit dhe masës së dënimit për të pandehurin Violand Braçellari, gjykata mban parasysh rrezikshmërinë e lartë shoqërore të veprës penale për të cilën ai akuzohet, e cila parashikon vetëm dënim me burgim dhe një masë dënimi nga 7-15 vjet burgim; Rrezikshmërinë e lartë shoqërore të autorit, i cili rezulton i dënuar më parë për të njëjtën kategori vepre penale, konkretisht në vitin 2013 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e ka dënuar me 3 vjet e 4 muaj burgim për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal; Qëndrimin e tij konsistent mohues ndaj veprës; Faktin se pavarësisht sasisë së vogël të lëndës narkotike të gjetur, sasia e saj ka qenë e konsiderueshme, por nuk është zbuluar se ku ndodhej; Faktin se kjo vepër penale ka një përhapje mjaft të lartë... etj. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se i pandehuri ndodhet në pozita rënduese. Duke vlerësuar në kompleksitet rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit, rrezikshmërinë e veprës, rrethanat e mësipërme, që vlerësohen si të rëndësishme për individualizimin e dënimit, masën e dënimit që parashikon dispozita 7-15 vjet burgim, Gjykata vlerëson se i pandehuri duhet të dënohet me 10 (dhjetë) vjet burgim, për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i KP”.

10. Kundër vendimit të gjykatë së shkallës së parë ka paraqitur ankim i dënuari Violand Braçellari, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe deklarimin e pafajshëm.

11. **Gjykata e Apelit Korçë**, me vendimin nr. 191, datë 17.07.2018 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. 657, datë 19.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë që i përket të pandehurit Violand Braçellari akuzuar për veprën penale të prodhimit e shitjes së narkotikëve në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

11.1 Gjykata e apelit, ndër të tjera arsyeton:Vendimi nr. 657, datë 19.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është i drejtë dhe ligjor si për sa i përket analizës së elementeve objektiv e subjektiv të veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i KP, ashtu dhe masës së dënimit të dhënë për të pandehurin Violand Braçellari, prandaj duhet të lihet në fuqi për të gjitha disponimet e tij....Gjykata e shkallës së parë, referuar rrethanave të çështjes, ka bërë një analizë të drejtë e ligjore të veprimeve që përbëjnë anën objektive dhe subjektive të veprës penale, të parashikuar nga neni 283/2 KP, veprimet e kryera nga i pandehuri, rrethanat e kryerjes se veprës penale, dashjen si formë faji, etj rrethana dhe, që janë bërë objekt i një analizë të plotë e ligjore të të gjitha provave shkresore të administruara në gjykim, të deklarimeve të marra nga personat që kanë dijeni për këtë vepër penale, nga personi nën hetim dhe të konkluzioneve të dhëna në aktet shkresore e shkencore që kanë marrë vlerën e provës në procesin gjyqësor...I pandehuri Violand Braçellari në bashkëpunim me persona të tjerë të pidentifikuar kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura dhe garantuara nga shteti për të ndaluar tregtimin, mbajtjen dhe transportimin e lëndëve narkotike, përdorimi i të cilave sjell pasoja të rënda për shëndetin dhe shoqërinë. Vepra penale është konsumuar me veprime aktive të të pandehurit, në formën e mbajtjes dhe të transportit të një sasive të konsiderueshme lëndë narkotike, si rezulton nga fotografitë e gjetura në aparatit e tij celular. Kjo vepër është kryer në bashkëpunim

me persona ende të pidentifikuar, fakt që rezulton nga mesazhet e gjetura në telefonin e të pandehurit. I pandehuri ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe nuk rezulton asnjë shkak padënueshmërie. I pandehuri e ka kryer veprën penale me dashje me qëllim përfitimi, edhe pse e ka ditur që kultivimi dhe transportimi i lëndëve narkotike dënohet penalisht. Nga sa më sipër rezulton se i pandehuri Violand Braçellari me veprimet e tij ka konsumuar të gjithë elementet e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i KP...Lidhur me masën e dënimit, gjykata e apelit vlerëson se kjo gjykatë, në kuptim të nenit 47 e vijues të KP i ka marrë drejt në vlerësim rrethanat që kanë të bëjnë me caktimin e llojit dhe masën e dënimit, në këto kushte kjo gjykatë çmon që masa e dënimit të dhënë për të pandehurin Violand Braçellari është mëse e përshtatshme për rrezikshmërinë e autorit dhe veprës penale dhe rrethanat e tjera të provuara gjatë gjykimit.... Pretendimet e ngritura në kërkesën ankimore janë të pabazuara e nuk mund të merren në konsideratë.... I pandehuri në ankimin e tij ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe deklarin e tij të pafajshëm me arsyetimin se nuk provohet që ai të ketë kryer këtë veprë penale... Sipas mbrojtësit të të pandehurit gjatë procesit gjyqësor gjykata duhet të kishte konstatuar shkeljet procedurale nga ana e policisë gjyqësore dhe vendimi i saj nuk është bazuar në prova të qarta që do të provonin përfshirjen e të pandehurit në këtë ngjarje kriminale. Ky pretendim referuar rrethanave të provuara në gjykim dhe provave të ndodhura në fashikullin hetimor rezulton i pabazuar. Veprimet e kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në momentin e ndalimit të të pandehurit janë në përputhje me kërkesat e ligjit duke respektuar të drejtat e tij...

11.2 Pavarësisht pretendimeve për parregullsi të cilat mbrojtja nuk ka mundur ti provojë, të gjitha rrethanat e provuara në gjykim, vërtetojnë pa asnjë lloj dyshimi që i pandehuri e ka konsumuar veprën penale për të cilën akuzohet, pasi nga rrethanat e çështjes është provuar plotësisht se veprimet e të pandehurit janë kryer në bashkëpunim me personat e tjerë, të pidentifikuar...Pavarësisht se nuk është bërë i mundur identifikimi i bashkëpunëtorëve të të pandehurit, referuar dhe nga qëndrimi i mbajtur dhe nga KB të GJL, i pandehuri me të drejtë është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikeve në bashkëpunim, pasi është provuar tërësisht bashkëpunimi i tij me persona të tretë për kryerjen e kësaj veprë. Secili prej personave të përfshirë në këtë veprimtari kriminale ka pasur rolin e tij në kryerjen e veprës, megjithëse nuk rezulton se këto role të kenë qenë të ndara saktësisht, pasi si i pandehuri dhe personat e tjerë kanë kryer një sërë veprimesh si organizator, ndihmës apo ekzekutor për realizimin e qëllimit kriminal....Drejt ka arsyetuar gjykata edhe ekzistencën e indiceve të rëndësishme të sakta dhe të lidhura me njëra tjetrën, sipas kërkesave të nenit 152/2 të KPP. Për sa i përket pretendimit në lidhje me vendin ku është gjetur sasia e lëndës narkotike prej 10,8 gr gjatë gjykimit është provuar plotësisht se kjo banesë është poseduar nga i pandehuri, pavarësisht se nuk ishte pronar i saj dhe gjetja e mbeturinave të shpërndara të lëndës narkotike, provon edhe njëherë aktivitetin e të pandehurit për mbajtjen dhe prodhimin e lëndës narkotike. Pretendimet e mbrojtjes se ngjarja mund të jetë sajese e policisë për të ndëshkuar të pandehurin, mbeten thjesht në kuadrin e dyshimeve të saj, pasi nuk bazohen në asnjë provë të paraqitur prej saj në gjykim. Kontrolli i banesës është kryer në prezencë të babait të të pandehurit, me të cilin jetonte bashkë i pandehuri e nuk ka asnjë veprim të paligjshëm të forcave të policisë për sajimin e situatave të qëllimshme gjatë këtij kontrolli. Edhe pretendimet e mungesës së bashkëpunimit janë përsëri të pabazuara. Mungesa e identifikimit të bashkëpunëtorëve të tjerë të veprës penale me emra dhe persona konkrete, nuk mund të sjellë mungesën e bashkëpunimit me të pandehurin e identifikuar pasi nga aktet e ndodhura në dosje është provuar plotësisht se i pandehuri Violand ka komunikuar me dy shtetasit Sandri dhe Toni në kuadër të kryerjes së veprimtarisë kriminale....

12. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë ka paraqitur rekurs i gjykuari Violand Braçellari, i cili kërkon: Ndryshimin e vendimit dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Violand Braçellari; në alternativë prishjen e dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, me një tjetër trup gjykues, duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i Gjykatës është i gabuar dhe në kundërshtim me provat e administruara.
- Vendimi i gjykatës është marrë në shkelje të rënda procedurale penale, të cilat kanë të bëjnë në thelb me mosrespektim të nenit 152 të KPP që ka të bëjë me mënyrën e çmuarjes së provave. Në rastin konkret gjykata në kapërcim të tagrave të veta ligjore dhe në njëanshmëri të plotë prej saj, ka pranuar të trajtojë me vlerën e provës edhe ato “prova” të cilat qartazi janë siguruar në kundërligjshmëri të plotë nga organi procedurës. Kështu megjithëse nga ana jonë iu kërkua gjykatës që në fillim të shqyrtimit gjyqësor (paraprakisht) si dhe gjatë gjykimit apo dhe në konkluzionet përfundimtare që të mos administronte si provë dhe aq më pak ti referohej në vendimmarrje pikërisht atyre provave të siguruar gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Shefqet Braçellari (ku u gjet dhe lënda narkotike), pasi një kontroll i tillë rezultoi qartë se ishte në kundërshtim të plotë dhe të hapur me ligjin procedural penal, pasi nuk ishin respektuar dukshëm rregullat procedurale penale që kanë të bëjnë me mënyrën e kontrollit të vendeve nga policia gjyqësore (si në aspektin formal ashtu dhe në aspektin thelbësor).
- Gjatë gjykimit nuk u sigurua asnjë provë direkte kundër të pandehurit, lidhur me akuzën në ngarkim të tij; kjo akuzë ngrihet në bashkëpunim me persona të pidentifikuar; në rastin konkret nuk rezultoi asnjë e dhënë në funksion të bashkëpunimit dhe për më tepër kur bëhet fjalë për posedim në banesë të një sasi të vogël prej 10 gram, mbetje të lëndës narkotike bimë cannabis sativa.
- Bashkëpunimi në kuptim të ligjit penal është një marrëveshje mes dy apo më shumë personave për të kryer një apo me shumë vepra penale ku roli i secilit nga bashkëpunëtorët është jo vetëm i nevojshëm por edhe i domosdoshëm. Bashkëpunimi në rastin konkret nuk mbështetet në asnjë provë. Pretendimi i akuzës për të paraqitur dhe për të dhënë vlerën e provës disa pamjeve filmike të siguruar në një aparat celulari, i cili ju gjet me vehte të pandehurit, nga i cili rezultojnë pamje me bimë narkotike, (*fakt ky i pranuar edhe nga gjykata në vendimin e saj*) nuk është gjë tjetër veçse konfirmim i mungesës së provave ligjore dhe reale nga akuzat në funksion të këtij procedimi penal.
- Është shpjeguar se aparati telefonik është blerë nga i pandehuri i përdoruar dhe ky i pandehur jo vetëm që nuk e ka ditur për ekzistencën e atyre pamjeve në atë aparat telefonik, por as dhe nuk di ta përdorë atë aparat, i cili është jo i zakonshëm dhe jo lehtësisht i përdorshëm. Por edhe sikur ai të kishte dijeni për ato pamje, për aq kohë sa nuk ka asnjë provë që të vërtetojë se ato pamje janë filmimi nga vetë ai celular dhe jo të dërguara në atë celular nga njëra anë dhe nga ana tjetër për aq kohë sa aty nuk ka asnjë shfaqje të këtij të pandehuri në ato pamje, si mundet që kjo e dhënë të përdoret si provë për ngritjen e një akuzë të tillë që nuk lidhet aspak me ato pamje, pasi bëhet fjalë në rastin konkret që ky i pandehur nuk akuzohet për lëndën narkotike që evidentohet në ato pamje por për një sasi prej 10 gram mbetje të gjetura në një banesë të braktisur në fshatin Lozhan, por në pronësi të shtetasit Shefqet Braçellari. Pra lehtësisht rezultoi se në gjykim, pala akuzatore nuk paraqiti asnjë provë logjike, proceduralisht të vlefshme në funksion të vërtetimit të akuzës që vetë ka ngritur ndaj këtij të pandehuri.
- Procesverbali i kontrollit është firmosur në mënyrë abuzive nga persona të cilët nuk kanë marrë pjesë në kontroll siç ishte dhe babai i të pandehurit shtetasi Luan Braçellari, i cili objektivisht nuk mund të merrte pjesë, për shkak se ai është një njeri pa këmbë i cili nuk mund të ecë.
- A mund të jetë i vlefshëm proceduralisht një akt kontrolli i banesës i kryer në këto rrethana dhe a mund të shërbejë si provë ajo çka përshkruhet në atë procesverbal, ndërkohë që i pandehuri

kundërshton fuqishëm duke thënë së kjo është lënë aty është lënë nga vetë policia gjatë kësaj mënyre kontrolli ? Në të vërtetë ligji procedural e ka zgjidhur çështjen, duke parashikuar se nëse gjatë një kontrolli banese nuk respektohen rregullat procedurale për realizimin e atij kontrolli, rezultati i përfutur është i papërdorshëm në gjykim (neni 202 e vijues i KPP). Ndaj unë me të drejtë them së kjo lëndë narkotike e gjetur në këtë banesë siguroar si rezultat i veprimeve proceduralisht të paligjshme të policisë gjyqësore nuk mund të shërbejë si provë për të fajësuar këtë të pandehur. Në rastin konkret jemi në kushtet e parashikuara nga pika 4 e nenit 151 të KPP, ku parashikohet ndalimi si provë i saj. Nga ana tjetër bëhet një lidhje e çuditshme nga akuza dhe gjykata lidhur me atribuuimin e kësaj lënde narkotike pikërisht të pandehurit Violand, i cili në fakt nuk është as pronari i kësaj banese, as poseduesi i saj dhe për më tepër që ai as ka jetuar në atë kohë në atë fshat, por në Vlorë, përveçse ka ardhur aty rrallë për të vizituar prindërit e tij. Atëherë cilat janë provat që e lidhin këtë të pandehur me këtë lëndë narkotike?

- Gjykata ka shkelur haptazi parashikimet e nenit 4 të KPP sipas të cilave është parashikuar detyrimi për gjykatën që të çmojë dhe vlerësojë dyshimet rreth provave dhe akuzës në favor të të pandehurit dhe jo në favor të palës akuzatore. Në këtë mënyrë gjykata nëpërkëmbi në këtë proces gjyqësor edhe garancitë kushtetuese të të pandehurit brenda këtij procesi penal kundër tij.

- Vendimi i gjykatës në fakt bie ndesh edhe me dëshmitë e dëshmitarëve të pyetur në seancë gjyqësore, të cilët kanë dëshmuar rrethana sipas të cilave akuza ka rënë dhe është vërtetuar dukshëm se i gjithë procesi penal kundër këtij të pandehuri ka qenë një montim policor në shkelje flagrante të Kushtetutës dhe ligjit procedural penal.

- Në të tilla rrethana, i mbrojturi prej meje nuk ka kryer asnjë veprim të dënueshëm penalisht. Ai nuk ka konsumuar veprën penale, të parashikuar nga neni 283 sipas paragrafit të dytë (siç akuzohet) dhe as sipas paragrafit të parë. Ai nuk ka asnjë lidhje me sasinë prej afro 10 gram cannabis sativa të gjetur në formë mbetjesh në banesën e shtetasit Shefqet Braçellari dhe as nuk ka bashkëpunuar me ndonjë person tjetër imagjinar për të mbajtur këtë sasi. E gjithë kjo çështje prej nesh konsiderohet një sajese dhe montim policor i tipit të frikshëm dhe që ia ka kaluar dhe ish- sigurimit të shtetit nga mënyra e servirjes së “fakteve” dhe “provave”, të cilat e theksoj së janë proceduralisht të pavlefshme dhe të papërdorshme në gjykim. Në këto kushte mendoj së vendimi i gjykatës është një vendim absolutisht i pavlefshëm dhe rezultat i shkeljeve të rënda procedurale penale, të cilat e bëjnë atë të pavlerë apo minimalisht kanë ndikuar ndjeshëm në vendimmarrje. Ndaj ky vendim duhet të priset dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim. Ndërsa lidhur me themelin e çështjes, qartazi rezulton se i pandehuri nuk ka konsumuar këtë vepër penale dhe ai duhet të shpallet i pafajshëm.

- I gjykuari/rekursues Violand Braçellari, në datë 29.10.2020 ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë plotësim rekursi, në të cilin, përmbledhtazi, parashtron pretendime të njëjta me rekursin e paraqitur nga ana e tij, duke kërkuar deklarimin e pafajshëm lidhur me akuzën.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

13. Në shqyrtimin e pretendimeve të rekursit të paraqitur, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) mban parasysh rregullimet kushtetuese mbi kufijtë e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë, nenin 141, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (ligji nr. 76/2016, datë 22.07.2016), sipas të cilit Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit, për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore në përputhje me të. Ky parashikim kushtetues është shoqëruar me ndërhyrje përkatëse në Kodin e Procedurës Penale (KPP), duke e pozicionuar Gjykatën e Lartë si një gjykatë ligji në sferën e shqyrtimit të të cilës nuk hyjnë çështjet të vlerësimit të fakteve dhe provave.

14. Kolegji mban në vëmendje dhe ndryshimet ligjore që ka pësuar KPP me ligjin nr. 41/2021, hyrë në fuqi në datën 29.05.2021. Në nenin 38 të ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore, parashikohet se: “1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekursitet e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre”. Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji Penal zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

15. Kolegji vlerëson se rekursi nga i gjykuari Violand Braçellari i plotëson kriteret formale procedurale, pasi është nënshkruar nga mbrojtësi dhe është paraqitur brenda afatit ligjor, të parashikuar nga neni 435 i KPP. Prokurori pranë Gjykatës së Apelit Korçë është njoftuar rregullisht për rekursin e paraqitur nga i gjykuari.

16. Në rekurs pretendohet për mosrespektim të ligjit procedural penal nga ana e Gjykata e Apelit Korçë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, por në rekurs shtjellohen përmbledhtazi pretendime lidhur me vlerësimin e gabuar të provave, duke pretenduar se gjykatat, në kundërshtim me parashikimet e nenit 152 të KPP, provave të paraqitura nga organi i akuzës i kanë dhënë vlerë të paracaktuar.

17. Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit, referuar nenit 432 të KPP mund të bëhet për këto shkaqe: a) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; c) kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

18. Lidhur me rekursin e paraqitur, Kolegji rithekson që, fillimisht, duhet vënë në dukje se Kolegji Penal nuk e shqyrton rekursin në drejtim të përcaktimit/provueshmërisë së fajësisë ose jo të të gjykuarit në këtë gjykim, pasi kjo është një çështje që iu përket gjykatave të faktit. Gjykata e Lartë nuk është gjykatë fakti, por një gjykatë ligji që kontrollon vendimet e gjykatave më të ulëta vetëm në drejtim të zbatimit të ligjit material apo procedural penal. Mënyra e vlerësimit të fakteve dhe provave, sipas qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit Penal, është një çështje që del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

19. Megjithatë, Kolegji ka detyrimin të shqyrtojë brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs, nëse nga gjykatat më të ulëta është zbatuar drejt ligji material apo procedural penal me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore dhe nëse vendimmarrja e tyre është në përputhje me praktikën e Kolegjit Penal ose praktikën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në këtë kontekst, në të gjitha rastet kur rekursi nuk i përmbahet shkaqeve të përcaktuara nga ligji procedural penal (veçanërisht pretendimet që kanë lidhje me vlerësimin e provave të shqyrtuara nga gjykatat e faktit), Kolegji Penal vendos mospranimin e rekursit të paraqitur.

20. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, nga aktet rezulton se Gjykata e Apelit Korçë, e vënë në lëvizje mbi ankimin e të pandehurit Violand Braçellari, si gjykatë fakti dhe ligji, ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, duke marrë në shqyrtim dhe i dhënë përgjigje pretendimeve të të pandehurit apelues në këtë proces penal. Ndryshe nga sa është pretenduar në ankim, ajo gjykatë, në analizë të tërësisë së provave të administruara dhe vlerësuara, në përputhje me parashikimet e ligjit procedural penal, nenet 152 e vijues të KPP, ka arritur në përfundimin se është provuar jashtë çdo dyshimi *fakti që, i pandehuri* me veprimet e tij të kundërligjshme ka

konsumuar elementet e veprës penale, të parashikuar nga neni 283/2 i KP, për të cilën akuzohet; po kështu, ajo gjykatë ka arsyetuar se Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, përveç analizës së hollësishme dhe objektive të provave të marra në shqyrtim, njëkohësisht iu ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të paraqitura nga mbrojtësi gjatë gjykimit dhe nuk gjen shkak ligjor për cenimin e vendimit.

21. Ndryshe nga sa pretendohet në rekursin e paraqitur, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë është rrjedhojë i zbatimit të drejtë të ligjit procedural dhe material penal, se nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, të tillë që të ndikojë në dhënien e vendimit, në dëm të të gjykuarit, si dhe nuk rezulton që vendimi i ankimuar të vijë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

22. Për sa u thanë më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se, rekursi i paraqitur nga i gjykuari Violand Braçellari, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP dhe për rrjedhojë ky rekurs nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke u mbështetur në nenet 433 dhe 441, pika 1, shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale;

V E N D O S I:

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari Violand Braçellari, kundër vendimit nr. 191, datë 17.07.2018 të Gjykatës së Apelit Korçë.

Tiranë, më datë 25.01.2024